



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nr. 133/Prot
3

Datë 21/11/2023

URDHËR

Nr. 16 datë 21/11/2023

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR
TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS 2023-2025

Bazuar në VKM nr.635, datë 25.09.2019, "Për Rregullat e Organizimit dhe të Funkcionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", pika 4 gërma "c", në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.1883/1 prot, datë 22.06.2023, sa më poshtë.

U r d h ë r o j:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës 2023-2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri të gjithë punonjësit e Agjencisë.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.





PLANI I INTEGRITETIT

2023-2025

Miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës Nr.16, datë 21/11/2023

Grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës:

1. Arda Hoxha, Përgjegjës, Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Fëmijës
2. Anila Bregu, Specialist, Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Fëmijës
3. Elona Halilosmani, Specialist, Sektori i Koordinimit dhe Statistikave
4. Biku Kalemasi, Specialist, Sektori i Koordinimit dhe Statistikave
5. Elisa Dizdari, Specialist, Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Fëmijës
6. Marjeta Gjellaj, Specialist, Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Fëmijës

TABELA E PERMBAJTJES

I. Rëndësia e Planit të Integritetit	5
Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në agjenci	5
Faza I: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore	5
Faza 2: Identifikimi dhe analizimi rreziqeve të integritetit.....	5
Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi	6
Metodologjia.....	6
2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit	6
Objektivi I: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në agjenci.....	6-7
Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në agjenci	7
Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun.....	7
Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar	7-8
Plani i Veprimit.....	8
Objektivi I: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në agjenci.....	8-9
Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri.....	9-10
Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun.....	10-11

I. RËNDËSIA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Integriteti është me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e institucioneve publike transparente dhe të përgjegjshme dhe bën që qytetarët të rrisin besimin tek institucionet për mbrojtjen e interesave të tyre ligjore.

Sistemi i integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës kërkon mekanizma funksional dhe autoritete të përgjegjshme për koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Në këtë kuader, del qartësisht nevoja për të hartuar politika dhe programe që do të garantonin mirëqenien dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës dhe do të ulnin nivelin e korrupsionit.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), është e angazhuar për forcimin e parimeve etike të administratës publike, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucion. Për këtë arsye, Agjencia ka hartuar dokumentin e Planit të Integritetit, ku trajtohen çështje të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit në këtë institucion.

Ky Plan Integriteti do sjellë përmirësime të rëndësishme në sistemin e qeverisjes mirë, koordinimin e shërbimeve dhe llogaridhënien dhe më konkretisht në:

- Përmirësimin e kuadrit rregullator dhe politik të agjencisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- Forcimin e burimeve njerezore duke bërë që administrata të karakterizohet nga etika dhe integriteti dhe forcimi i përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e drejtimit;
- Përmirësimin e mekanizmave të planifikimit, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve publike;
- Përmirësimin e transparencës së agjencisë në ndarjen e informacioneve me publikun.

1.1 PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT NË AGJENCI

Plani i Integritetit është rezultat i një analize gjithëpërfshirëse të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të rrezikut të integritetit në agjenci.

Në këtë proces u vlerësuan rreziqet e integritetit, parregullsitë sipas fushave të veprimtarisë së Agjencisë: menaxhimi financiar; menaxhimi i burimeve njerezore; arkiva, ruajtja dhe administrimi i dokumenteve zyrtare. Instrumenti metodologjik i përdorur është metodologjia për Vlerësimin e Rrezikut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore.¹ Ky vlerësim u zbatua nga grupi i punës për hartimin e planit të integritetit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, i ngritur me punonjës të agjencisë.

Faza I: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerezore

Për hartimin e planit të integriteti u ngrit një grup pune mbështetur në Urdhrin e Kryetarit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Nr.133/1 prot, date 4.09.2023, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit" në përbërje të të cilit janë Koordinator dhe 5 anëtarë.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi rreziqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kuadrin ligjor, rregullator, strategjik si dhe dokumente të ndryshme pune të kësaj agjencie. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i punës, vijoi me identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës të agjencisë.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Gjatë kësaj faze të procesit, grupi i punës, hartoi planin e veprimit për menaxhimin e rreziqeve të integritetit. Nga analiza e të dhenave rezultoi se agjencia kishte hartuar dhe vene në zbatim mekanizma për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit. Analiza e realizuar në fazën e mësipërme diktoi nevojën për të përmiresuar kuadrin rregullator të brendshëm dhe marrjen e masave për zhvillimin e burimeve njerëzore të agjencisë përmes: njohjes dhe zbatimit të rregullave për konfliktin e interesit dhe të etikës, aksesit në informacionin publik dhe konsultimin publik.

1.2 METODOLOGJIA

Grupi i punës, në procesin e hartimit të planit të integritetit, ka përdorur dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cënueshmërinë e integritetit: metoda cilësore dhe sasiore. Në metodën cilësore përfshihej një analizë e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (shqyrtim literature), ku përfshihen, rregullore dhe akte të brendshme, urdhra si dhe manuale. Po ashtu, u analizuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e Agjencisë të hartuara nga stafi i Agjencisë si edhe përmbledhjet e praktikave më të mira të integritetit.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, ku përmes diskutimit dhe vlerësimit nga stafi i Agjencisë i çështjeve të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Vlerësimi trajton nivelin e zbatimit të ligjit, procedurat e rekrutimit, vlerësimin e performancës, zhvillimin në karriere, komunikimin e brendshëm.

OBJEKTIVI 1: PERMIRESIMI I KUADRIT RREGULLATOR E INSTITUCIONAL TE ETIKES DHE INTEGRITETIT NE AGJENCI

Kuadri i brendshëm rregullator që mundëson standardet dhe normat e etikës e integritetit si dhe zhvillon burimet njerëzore për zbatimin e tyre është parakusht për të siguruar një

administratë efikase, profesionale dhe me integritet.

Përmirësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit të integritetit në agjenci do të trajtohet përmes rregullores së brendshme, Kodit të Etikës. Agjencia do të sigurojë që parimet e etikës të respektohen nga punonjësit e institucionit, në mënyrë që mekanizmat e menaxhimit të tyre të jenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për konfliktin e interesave, dhe rregullat e etikës në administratën publike. Në keto dokumente të Agjencisë janë përcaktuar vlerat organizative, standardet e sjelljes së mire, modeli i lidershit të institucionit si dhe qëndrimet dhe sjelljet e punonjësve.

Kultura e integritetit synohet të perforcohet nëpërmjet përmirësimit të politikave të ministrisë dhe procedurave që synojnë të trajtojnë konfliktin e interesit, dhuratat dhe përfitimet e tjera të çdo lloji, interesat e tjera të deklarueshme, veprimtaritë e jashtme, bullizmin dhe ngacmimin në punë, apo edhe privatësinë dhe konfidencialitetin.

OBJEKTIVI 2: KONSOLIDIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË AGJENCI

Për konsolidimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, Agjencia do të synojë propozimin në Ministri të kapaciteteve teknike të burimeve njerëzore për realizimin me rigorozitet të objektivave ligjore. Në këtë mënyrë, institucioni do të përmbushë me së miri realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të shtuara në ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Agjencia angazhohet të zbatojë në mënyrë objektive Ligjin "Për shërbimin civil", i cili në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, ka si bazë parimet e mundësive të barabarta, mos-diskriminimit, meritokracisë, transparencës, profesionalizmit që garantojnë qëndrueshmërinë e nëpunësve civile si dhe vazhdimësinë e shërbimit civil në këtë institucion.

OBJEKTIVI 3: RITJA E TRANSPARENCES NË NDARJEN E TË DHENAVE ME PUBLIKUN

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), ka detyrimin ligjor kontrollin e cilësisë së punës të strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor. Transparenca e Agjencisë gjatë procesit të realizimit të zbatimit të legjislationit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës është shumë e rëndësishme për ritjen e pjesëmarrjes së publikut në kontrollin e veprimtarisë tonë.

Në këtë kuadër, Agjencia do të mbështesë ofrimin e informacionit publik, përdorimin dhe

analizën e informacionit, si dhe do të përmiresojë në mënyrë të vazhdueshme Programin e Transparencës.

OBJEKTIVI 4: PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT, TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Forcimi i luftës kundër rreziqeve të integritetit nga Agjencia synohet të realizohet edhe nëpërmjet forcimit të kontroleve të integritetit në fushat e planifikimit, vendimmarrjes, monitorimit dhe projekteve në sektorin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Në këtë kuadër, kontrolli i zbatimit të legjislacionit do të mbështetet tek instrumente metodologjike, procedurat e qarta dhe të përshtatshme, si edhe në rritjen e transparencës së proceseve.

Përditesimi i planifikimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të legjislacionit në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës bazuar në raporte të ndryshme vlerësimi do të bëjnë të mundur realizimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave të nevojshme, në kuadër të ngritjes dhe zbatimit të standardeve për një sistem funksional të integruar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

3. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të trajtuar rreziqet dhe faktorët e rreziqeve të integritetit, të vleresuara sipas fushës së përgjegjësisë së Agjencisë. Në këtë plan jepen përshkrime për aktivitete të caktuara, për strukturat apo funksionet përgjegjëse të institucionit, si edhe afatet kohore për zbatimin e tyre. Me realizimin e këtyre aktiviteteve synohet përmbushja e objektivave të identifikuar në Planin e Integriteti dhe forcimi i integritetit mbështetur në përvorjet dhe praktikatat më të mira të mirëfunksionimit të administratës publike.

Plani i Veprimit është një dokument që mund të ndryshohet dhe përmiresohet nga ministria sipas nevojës dhe situatave. Zbatimi i këtij plani do të pasohet nga një fushatë ndërgjëgjësimi dhe informimi brenda dhe jashtë institucionit, në mënyrë që integriteti në këtë institucion të kuptohet drejt.

Plani i Veprimit është hartuar në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë Antikorrupsion 2020-2023. Ndonëse ky dokument ka të bëjë vetëm me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ai është në përputhje me politikat kombëtare kundër korrupsionit

OBJEKTIVI 1. PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE INSTITUCIONAL TË ETIKËS DHE INTEGRITETIT NË AGJENCI

Nr.	Rreziku dhe ngjarja e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandimet)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteve
1	Njohuri të kufizuara të punonjësve të Agjencisë për: rregullat e etikës, konfliktit të interesit, deklarime dhuratave, veprimtarive të jashtme, të drejtën për informim dhe kufizimet e saj, të dhënat personale si dhe informacionet e klasifikuara konfidenciale	Veprimtaria/reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	Përfshirja e temave të trajnimit të këtyre çështjeve në planin vjetor të trajnimit të ASHDMF	Përditësimi i planit të trajnimeve, Burimet Njerëzore. viti 2024, 2025
2	Mungesa e specialistëve përgjegjës dhe të dedikuar për kryerjen e funksioneve të Financës, Burimeve Njerëzore, Arkives,	Veprimtaria/reputacioni dhe imazhi i institucionit	I lartë	Hartimi i propozimit për strukturën e re të ASHDMF ku përfshihen edhe planifikimet për specialistët e nevojshëm	Kryetari Specialisti që mbulon burimet njerëzore Gjashtëmujori i parë i vitit 2024

OBJEKTIVI 2: KONSOLIDIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË ASHDMF

Nr.	Rreziku dhe ngjarja e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandimet)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteve
1	Plani vjetor i trajnimeve nuk është i përditësuar me nevojat ASHDMF	Veprimtaria/reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	Të përditësohet plani gjithëpërfshirës i trajnimeve ku të përfshihen trajnimet e ofruara nga ASPA	Kryetari i ASHDMF dhe Specialisti i burimeve njerëzore. Gjashtëmujori i parë 2024
2	Rregullat për dorëzimin e detyres nga punonjësit në rastin e largimit nga puna nuk janë efektivuar në kuadrin e brendshëm rregullator	Veprimtaria	Mesatar	Të përfshihen rregullat për dorëzimin e detyrës në rregulloren e	Grup pune me punonjës të ASHDMF për përfshirjen e këtyre rregullave në

				brendshme të institucionit.	rregulloren e brendshme Gjashtemujori i parë 2025
3.	Rregullat për emërimin dhe lirim nga detyra të punonjësve të ASHDMF sipas ligjit për nëpinësin civil në kuadrin e brendshëm rregullator	Veprimtaria	I Lartë	Të përfshihen rregullat për emërimin dhe lirim nga detyra sipas legjislacionit për nëpunësit civil në rregulloren e brendshme të institucionit	Grup pune me punonjës të ASHDMF për përfshirjen e këtyre rregullave në rregulloren e brendshme Gjashtemujori i dytë 2024
4.	Rregullat për masa disiplinore të punonjësve sipas ligjit për nëpunësit civil	Veprimtaria	Mesatar	Të përfshihen rregullat për masa disiplinore sipas legjislacionit për nëpunësit civil në rregulloren e brendshme të institucionit	Grup pune me punonjës të ASHDMF për përfshirjen e këtyre rregullave në rregulloren e brendshme Gjashtemujori i parë 2024

OBJEKTIVI 3. RRRITJA E TRANSPARENCES NË NDARJEN E TË DHËNAVE ME PUBLIKUN

Nr	Rreziku dhe ngjarja e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandimet)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteve
1.	Burime njerëzore të pamjaftueshme për koordinimin e veprimtarive të transparencës	Veprimtaria	Mesatar	Të vlerësohet struktura e institucionit	Kryetari i Agjencisë, Viti 2024,2025

OBJEKTIVI 4. PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT, TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Nr.	Rreziku dhe ngjarja e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut (Burimi i rrezikut/lloji i ndikimit)	Rreziku i brendshëm	Kontrolli (rekomandimet)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteve
1.	Ngarkesë pune të Specialistit Financier, në raport me burimet njerëzore dhe protokollin	Veprimtaria/burime njerëzore	mesatar	Propozim në Ministri për strukturën e re për ASHDMF	Kryetari ASHDMF, Specialisti që mbulon burimet njerëzore Gjashtëmujori dytë parë i vitit 2024

--	--	--	--	--	--